

Informacion për ty që regjistrohesh në regjistrin BPSD

Kualitet më i mirë për ty një mjekësi

Për të siguruar zhvillimin dhe kualitetin e mjekimit dhe përkujdesjes përdoret regjistri kombëtar i kualitetit. Regjistri e bënë të mundur përcjelljen dhe përmirësimin e mjekësisë dhe përkujdesjes, dhe sa më shumë që marrin pjesë, rezultati del më i sakt. Duke i lejuar të dhënat tuja të gjenden në regjistrin e kualitetit Ti merr pjesë në përmirësimin e mjekësisë dhe përkujdesjes.

Ky informacion bënë fjalë për regjistrin BPSD, një regjister suedez i kualitetit – Simtomet Psiqike dhe Sjelljes në rast të Demencës. Qëllimi i regjistrit BPSD është rritja e mirëqenies dhe zvogëlimi i vuajtjes së personave që vuajnë nga sëmundje të demencës duke i zvogëluar simtomet psiqike dhe sjelljes (BPSD). Puna në regjister ndërtohet në masa mjekimi të përqendruara duke u bazuar në nevojat dhe resurset e secilit person. Të dhënat që regjistrohen janë psh. masat e mjekimit, numri personal, diagnoza dhe ilaçet.

Për ta zhvilluar dhe siguruar mjekimin dhe përkujdesjen (shkruaj emrin e dhënësit të mjekimit)

do të raportoj të dhëna për Ty në regjistrin BPSD. Të dhënat tuja mbrohen me ligj dhe fshihen kur nuk janë më të nevojshme. Ti po ashtu mund t'i heqësh të dhënat Tuaja apo të deklarohesh se *nuk do* të regjistrohesh.

Kështu trajtohen të dhënat tuaja në regjistrin e kualitetit

Të dhënat për Ty mbledhen nga Ti vet dhe nga zhurnali i Juaj. Të dhënat mund të përdoren vetëm për të zhvilluar dhe siguruar kualitetin e mjekësisë dhe përkujdesjes, për të bërë statistikë dhe për hulumtime në kuadër të mjekimit dhe përkujdesjes. Ata që duan t'i përdorin të dhënat për qëllimet e sipër përmendura mund ta bëjnë këtë pas një shqyrtimi sigurie. Kur zhvillohen studime hulumtimi kërkohet një miratim nga komisioni për çështje etike (EPN)

Sekrete Të dhënat Tuaja mbrohen nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave. Kjo do të thotë se të dhënat tuaja nga regjistri mund t'i jepen palës së tretë vetëm nëse është plotësisht e qartë se as ti por as familjarët e Tuaj nuk dëmtoheni nga kjo. Ky shqyrtim bëhet nga përgjegjësi kryesor i këtij regjistri.

Siguria Të dhënat Tuaja mbrohen përmes kontrolleve teknike, përmes rutinave dhe kërkesave të veçanta për autorizim. Kjo bëhet në mënyrë që vetëm ai/ajo që ka nevojë për to mund të ketë qasje në to dhe t'i marr në mënyrë të sigurt.

Qasje në të Dhëna Mjekuesi i ytë mund të ketë qasje në të dhënat e lëna në regjister dhe ata që në qendër e menaxhojnë regjistrin mundën dhe u lejohe të kenë qasje në të dhënat e Tuaja. Asnjë mjekues tjetër nuk qasje në këto të dhëna.

Fshirja Të dhënat Tuaja fshihen kur nuk ka më nevojë për të zhvilluar dhe siguruar kualitetin në mjekësi.

Baza ligjore

Të gjithë ata që trajtojnë të dhëna personale duhet të bazohen në akte ligjore.

Emri i njësisë regjistruese;

dhe Drejtoria Rajonale për Rajoni Skåne mund të mbledhin dhe të regjistrojnë të dhëna në regjistrin BPSD sepse konsiderohet se përbën një të dhënë të domosdoshme për interesin publik në shoqëri (nen 6.1 e). Ne po ashtu mund të trajtojmë të dhëna për shëndetin sepse është e domosdoshme për arsye të njëjta që kanë lidhje me mjekësinë profesionale dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore (nen. 9.2 h). Personeli ynë dhe personeli në Drejtorinë Rajonale në Rajonin Skåne përfshihen po ashtu nga ligji për sekret profesional (nen. 9.3). Po ashtu kërkohet mbështjete ligjore sipas udhëzimit për mbrojtjen e të dhënave kur bëhet trajtimi i të dhënave personale në regjistrin e kualitetit. Këto dispozita gjenden në nen. 7 ligji për pacientë (2008:355).

Të drejtat e Tuaja

Pjesëmarrja e juaj në regjister është vullnetare dhe nuk ndikon në mjekimin që të jepet. Mjekuesi i ytë, i cili regjistron të dhëna për Ty, është përgjegjës që regjistrimi të bëhet në mënyrë korrekte në regjistrin e kualitetit. Nëse nuk dëshiron që të dhënat Tuaja të regjistrohen, mund t'i drejtohesh mjekuesit Tuaj.

Ti ke të drejtë që në çdo kohë të kërkosh heqjen e të dhënave Tuaja nga regjistri. Drejtohu tek personi kontaktues në regjistrin BPSD (të dhënat e kontaktit i gjenë në fund të dokumentit).

Ti mund të informohesh se cila njësi dhe në cilën kohë është njoftuar me të dhënat Tuaja.

Ti ke të drejtë që kërkosh korrigjimin e të dhënave të gabuara dhe të kompletosh të dhënat jo të plota.

Ti ke të drejtë që pa pagesë të njoftohesh se cilat të dhëna për Ty janë regjistruar, përmes një ekstrakti të regjistrin. Një kërkesë e tillë duhet të bëhet me shkrim, të nënshkruhet dhe të dërgohet te personi kontaktues për regjistrin kombëtar të kualitetit.

Ti ke të drejtë në rrethana të caktuara të kërkosh kufizimin e trajtimit të dhënave personale nëse kontestohet korrektësia e të dhënave personale.

Të dhëna kontakti

Regjistri BPSD

BPSD-registret

VO Kognitiv medicin

Ängelholms sjukhus

262 81 Ängelholm

Faqa në internet: www.bpsd.se

Telefoni: 040-33 55 78

E-maili: bpsd.sus@skane.se

Personi përgjegjës në Qendër (CPUA) sovrani i regjistrit BPSD është Region Skåne

Shefi i veprimtarisë Mikael Åström

E-maili: Mikael.Astrom@skane.se

Përfaqësusi për Mbrojte të Dhënave: Kajsa Thelin

Udhëheqja e informacionit, Dockplatsen, Malmö

E-maili: Kajsa.Thelin@skane.se

Mjekuesi

Përfaqësusi për Mbrojte të Dhënave:

Adresa:

Telefoni:

E-maili: